



Planuar / Dorezuar Priljeno / Prodato Received / Delivery	07-05-2021	1	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHIK	2289/2021		119



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.250/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.250/2021 të datës 02.04.2021 të parashtruar nga ankuesja në çështjen juridike "transferim", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 47 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 07.05.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Detyrohet Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të shqyrtoj kërkesën e datës 18.02.2021, të parashtruar nga Udhëheqësja e Personelit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- II. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të ndërmerr veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me datë 02.04.2021, ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1598/2021 të regjistruar me numër A.nr.250/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor për mos realizimin e kërkesës për transferim të përhershëm në një pozitë të njëjtë apo të ngjashme dhe në gradë të njëjtë, brenda institucionit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 14.04.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 1777/2021 të Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Këshilli me datën 16.04.2021 ka pranuar përgjigje në ankesë me numër protokolli 1828/2021 nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë me provat fq.1/19.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A. nr. 250/2021 e datës 02.04.2021, me numër protokolli 1598/2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e Komisionit Mjekësor i datës 01.02.2021, i Komisionit Mjekësor të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale; kërkesën nr. protokolli 1511 e datës 16.02.2021 drejtuar Udhëheqëses së Divizionit të Personelit; Përgjigjën në ankesë e datës 16.04.2021 me numër protokolli 1828/2021, e-maili i datës 23.10.2020 i ankueses drejtuar Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore; e-maili i datës 26.10.2020 nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore; Raportin mjekësor i datës 14.11.2020; Akt emërimi i datës 30.01.2012, i ankueses Përshkrimi i detyrave të Punës i ankueses E-maili i datës 18.02.2021, i Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore drejtuar zyrtareve të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik (DZPM) Ili; , me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka vendosur për detyrimin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, që të shqyrtoj kërkesën për transferim të përhershëm të datës 18.02.2021, dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim me legjislacionin në fuqi, *sepse*:

Bazuar në provat e lëndës, gjegjësisht Akt Emërimin e datës 30.01.2012, Kolegji ka konstatuar se ankuesja është e sistemuar në pozitën e punës Zyrtare e Arkivit në Divizionin e Personelit, pranë Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Ankuesja me datë 23.10.2020, ka parashtruar kërkesë të Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore, që për shkaqe shëndetësore ti mundësohet transferimi në një vend tjetër pune në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. Në përgjigje të kërkesës së ankueses, Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore, ka udhëzuar ankuesen që të parashtrroj kërkesë në formë të shkruar dhe të njëjtës ti bashkëngjites dokumentacionin mjekësor respektivisht vërtetimin e gjendjes shëndetësore nga organi kompetent-Komisioni Mjekësor i Ministrisë së Punës, në mënyrë që kërkesa të adresohet me tej në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

Ankuesja me datë 16.02.2021 ka parashtruar kërkesë të re të Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore, për transferimin e saj të përhershëm në një pozitë tjetër për shkak të pa aftësisë shëndetësore, duke ofruar edhe Formularin e datës 01.02.2021 të Divizionit të Komisioneve Mjekësore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, me të cilin nuk është evidentuar se ankuesit i është caktuar ndonjë lloj i paaftësisë së përhershme veçse është dhënë rekomandim për ndërrim të vendit të punës.

Me datë 18.02.2021, Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore ka përcjellë në Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik (DZPM), kërkesën dhe dokumentacionin e parashtruar nga ankuesja për transferimin e përhershëm për shkak të paaftësisë shëndetësore, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë nuk ka nxjerrë vendim lidhur me kërkesën e parashtruar të datës 18.02.2021.



Pas heshtjes administrative të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, ankuesja parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyresh për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor që ti njihet e drejta për transferim të përhershëm për shkak të paaftësisë shëndetësore bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, duke propozuar që Këshilli ta detyroj Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që ankuesen ta transferoj në një pozitë të njëjtë apo të ngjashme brenda institucionit në pajtim me rekomandimin e Divizionit të Komisioneve Mjekësore të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 18 paragrafi 1 ku përcaktohet se: *“Çdo institucion siguron një ambient të sigurt e të përshtatshëm pune për mbrojtjen e integritetit fizik, moral dhe të dinjitetit të zyrtarit”* si dhe nenin 53 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të të njëjtit Ligj që përcakton se: *Transferimi i përhershëm është caktimi i detyrueshëm i nëpunësit civil në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil, në rastet: 1.1. të paaftësisë shëndetësore për të kryer detyrat e pozitës së mëparshme; dhe si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson së çdo institucion publikë ka detyrim ligjor që të siguroj ambient dhe kushte të përshtatshme pune për mbrojtje të shëndetit fizik dhe mendor të nëpunësve publikë, dhe së një nëpunës civil për shkak të paaftësisë shëndetësore të konstatuar nga Komisioni kompetent mjekësor, mund të kërkoj transferim të përhershëm në një vend tjetër pune të përshtatshme me shkallën e paaftësisë shëndetësore.*

Po ashtu, Kolegji për vlerësimin e drejt të pretendimeve ankimore ju referua edhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, respektivisht nenit 11, paragrafi 1 ku përcaktohet se: *1. Udhëheqësi i drejtpërdrejt i nëpunësit civil ose vetë nëpunësi civil mund të kërkojë transferimin në një pozitë tjetër të së njëjtës kategori ku është i aftë të kryejë detyrat. Kërkesa me shkrim duhet të jetë e arsyetuar dhe të njëjtës i bashkëngjitet vërtetimi i gjendjes shëndetësore nga organi kompetent mjekësor i siguruar sipas legjislacionit në fuqi dhe e njëjta i drejtohet njësisë përgjegjëse. Nëpunësi civil dëgjohet nga njësia përgjegjëse përpara se të marrë vendim dhe i paraqet asaj vërtetimin e gjendjes shëndetësore, e në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, si dhe bazuar në shqyrtimin e provave të lëndës, Kolegji ka konstatuar se ankuesja ka parashtruar kërkesë për transferim të përhershëm, duke i bashkëngjitur dëshminë mjekësore të lëshuar nga Komisioni Mjekësor kompetent dhe se njëjta i është adresuar për vendosje Njesisë përgjegjëse gjegjësisht Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, i cili nuk ka vendosur lidhur me kërkesën për transferimin e përhershëm të ankesës brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 11 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve ku përcaktohet se *“ Për institucionet e administratës shtetërore, DMZP merr vendim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt ose nëpunësi civil dhe vendos për transferimin në një nga këto institucione: 2.1. në një pozicion tjetër të njëjtit institucion ku është emëruar, duke përfshirë këtu edhe degët e tij lokale ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në një Agjenci Ekzekutive të institucionit ku është emëruar dhe degët lokale të saj; 2.3. në një institucion tjetër të administratës shtetërore.”**

Andaj, sipas rrethanave si me lartë, Kolegji konstaton së Drejtori i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë është i obliguar që në afatin e përcaktuar si në dispozitiv të këtij vendimi, të shqyrtojë kërkesën e datës 18.02.2021 të Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore për transferimin e përhershëm të ankueses dhe të nxjerr akt administrativ lidhur me kërkesën e parashtruar, duke vepruar në pajtim me dispozita përkatëse ligjore.



Bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmer veprimet në pajtim me nenin 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A. Nr. 250/2021

Rushit KAJTAZI

Zyrtar për Bashkëpunim Profesional

Ardita HAXHNIKAJ DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

1. Ankueses
2. Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publik;
3. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
4. Udhëheqësit të Personelit në Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
5. Arkivit të KPMSHCK-së,